



# **BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË MITROVICË**



*Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, për periudhën kohore Janar-Mars 2024.*

## Komunikatë për media

**Mitrovicë, 30 janar 2024**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë njofton opinionin se përkitazi me publikimin e video incizimit të portalit Nacionale, publikuar me datë 29 janar 2024, me qëllim të ndriçimit të gjitha fakteve dhe rrethanave, ka autorizuar Policinë e Kosovës – Drejtorinë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (DHTN) në Prishtinë, që të ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore lidhur me hetimin e këtij rasti, që ka të bëjë me persona të përfshirë që shihen në videot e publikuara, përfshirë identifikimin e të gjithë personave, pastaj mbledhjen e provave – video incizimeve të portalit Nacionale, dhe provave tjera relevante që janë të nevojshme për hetimin dhe ndriçimin e këtij rasti, në drejtim të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 lidhur me nenin 275 paragrafi 1 pika 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

---

## **Kërkesë për paraburgimin e zyrtarit të ATK që u ndalua duke kontrabanduar barna**

**Mitrovicë, 02 shkurt 2024**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për të pandehurin L.P., zyrtar i Administratës Tatimore të Kosovës, pasi ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 paragrafi 1, dhe “Kontrabandimi me mallra“ nga neni 311 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datë 01 shkurt 2024 në rrugën magjistrale Leposaviq – Mitrovicë përkatësisht në fshatin Bistricë, i pandehuri L.P., është ndaluar nga policia në pikë kontroll, i njëjti ka qenë duke e drejtuar veturën zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës.

Gjatë kontrollit në bagazh janë gjetur dy çanta me lloje të ndryshme të barnave me banderola të Serbisë, pa poseduar asnjë dokument përcjellës.

Seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit pritet të mbahet pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

---

## **Kërkesë për caktim paraburgimi për vrasje në tentativë**

**Mitrovicë, 21 shkurt 2024**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për të pandehurin B.O., pasi ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale “Vrasje në tentativë” nga neni 172 lidhur me nenin 28, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve“ nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datë 20 shkurt 2024, në fshatin Sllatinë të Vushtrrisë, i pandehuri me qëllim të privimit nga jeta të personit tjetër, pas një mosmarrëveshje rreth një prone të cilën po e punonte i dëmtuari N.V., i pandehuri nxjerr armën-revolen nga brezi dhe ka shtënë në drejtim të dëmtuarit, i cili nga predhat është goditur në trup.

Të pandehurit arma – revolja i është gjetur dhe konfiskuar gjatë kontrollit të shtëpisë nga ana e policisë.

I pandehuri gjendet në ndalim me aktvendim të prokurorit të shtetit.

Seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit pritet të mbahet pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

---

## **Kërkohet paraburgim për të pandehurin për laboratorin e drogës në Lepsaviq**

**Mitrovicë, 26 shkurt 2024**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për të pandehurin R.V., pasi ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale “Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike” nga neni 268 lidhur me nenin 31 e 275, dhe “Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit” nga neni 272 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I pandehuri, prej datës së pacaktuar e deri me datë 24 shkurt 2024, në shtëpinë e tij në fshatin Graniqane të Lepsaviqit, pa autorizim ka prodhuar, kultivuar përpunuar dhe nxjerrë ose përgatitur substanca preparate që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope, në atë mënyrë që i pandehuri në shtëpinë e tij i ka përshtatur dy dhoma në laborator duke shfrytëzuar aparatura të llojeve të ndryshme ku ka arritur që të kultivojë dhe prodhojë bimë të ndryshme narkotike.

Gjatë kontrollit nga policia në shtëpinë e të pandehurit, në njërin nga dhomat janë gjetur njëzetetë (23) saksi të mbjella me bimë të dyshuara të kanabisit me gjatësi 80.185 cm, llamba elektrike me nxemje elektrike, nxehëse që mban temperaturë konstante, foli alumini me të cilin ishte mbuluar dhoma dhe preparate për kultivimin e bimëve narkotike, ndërsa dhoma tjetër ishte djegur dhe janë vërejtur pajisjet e djegura që janë shfrytëzuar për kultivimin e bimëve narkotike.

I pandehuri me aktvendim të prokurorit të shtetit gjendet në ndalim nga data 24 janar 2024. Seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit pritet të mbahet sot, ditë e hënë, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

## **Kërkohet paraburgim për të dyshuarin për vjedhje të rëndë**

**Mitrovicë, 08 mars 2024**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Skenderaj, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për të pandehurin A.V., pasi ekziston dyshimi i bazuar se ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale “Vjedhje e rëndë”.

I pandehuri A.V., dyshohet se me datë 18 shkurt 2024, me të pandehurin I.K., së bashku traktorin e vjedhur në fshatin Tërnac të Skenderajt, përmes rrugëve ilegale malore e dërgojnë në Serbi.

Për këtë rast, me datë 05 mars janë ndaluar të pandehurit P.S., dhe V.K., për të njëjtit me datë 06 mars Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit, dhe ndaj të pandehurve të lartë cekur është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh, ndërkaq në arrati gjenden edhe të dyshuar tjerë.

Seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit A.V., pritet të mbahet sot, ditë e premtë, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Skenderaj.

---

## **Arrestohet një person për mashtrim të qytetarëve në vlerë rreth 2 milionë euro**

**Mitrovicë, 19 mars 2024**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, njofton opinionin se është arrestuar personi i dyshuar me iniciale J.M., me dyshimin se në periudha të ndryshme nga viti 2021 e gjer në muajin korrik 2023, në mënyrë mashtruese ka mashtruar qytetarë të ndryshëm, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete, dhe dyshohet se vlera e përfitimit është rreth 2 milionë euro.

Me këto veprime i dyshuari ka kryer veprën penale “Mashtrimi” nga neni 323 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I dyshuari, me vendim të prokurorit gjendet në ndalim 48 orësh, dhe në afatin e paraparë ligjor Prokuroria Themelore në Mitrovicë ndaj të dyshuarit do të paraqes kërkesë për caktimin e masës së sigurisë - masës së paraburgimit.



## **Kryeprokurori Ujkani pret në takim pjesëtarë të KFOR amerikan**

**Mitrovicë, 20 mars 2024**

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë z. Ismet Ujkani ka pritur në takim pjesëtarë të KFOR amerikan të kampit Bondsteel.

Gjatë takimit janë diskutuar çështje të ndryshme, dhe kryeprokurori Ujkani njoftoi të njëjtit lidhur me funksionimin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kompetencat, organizimin, dhe sfidat e punës në këtë prokurori.

Në fund të takimit të pranishmit u pajtuan për bashkëpunim të mëtutjeshëm në fushën e sundimit të ligjit.

## Aktakuzë kundër të pandehurit që privoi nga jeta vëllaun e tij

Mitrovicë, 27 mars 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, kundër të pandehurit E.J., për shkak të dyshimit të bazuar mirë për kryerjen e veprave penale “Vrasja e rëndë“ nga neni 173 paragrafi 1 pika 1.3 të KPRK, dhe “Mbajtja në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK.


Prokuroria njofton opinionin, se me datë 05 nëntor 2023 në banesën e tij në Mitrovicë – veri, i pandehuri me dashje ka privuar nga jeta viktimën – vëllaun e tij E.J., në atë mënyrë që pas një fjalosje të çastit, e sulmon viktimën me thikë të kuzhinës, me gjatësi tehu 12 cm, dhe e godet pesë (5) herë në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar plagë prerëse e shpuese, dhe si pasojë e lëndimeve të marra viktimë vdes në spitalin e Mitrovicës.

Po ashtu, i pandehuri, në shtëpinë e tij në Mitrovicë – veri, pa autorizim ka poseduar pistoletën e markës Kolt (ROHM RG 69) , 9 mm, prodhim gjerman.

Me këto veprime, i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë.

Prokurori i Shtetit, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin t`a shpallë fajtor për veprat e kryera penale dhe ta dënojë sipas ligjit.

### Pasqyra e përgjithshme sipas llojit të kallëzimit penal



	PP	PPN	PPN/M	PPP	NJN
Te trashguara	3025	2467	67	4795	28
Te pranuar	618	205	14	288	2
Te punuara	299	150	0	7	11
Te mbetura	3344	2522	81	5076	19

*Grafikoni 1: Paraqet të dhënat e përgjithshme statistikore sipas llojit të kallëzimit penal për periudhën Janar-Mars 2024*